



Rrëfimi i Artistes

SUZANA VARVARICA KUKA

Venera Kastrati është një nga artistet më të njohura për publikun shqiptar që jeton jashtë Shqipërisë. Prania e saj në ngjarje të rëndësishme të artit bashkëkohës në mjediset shqiptare nuk ka kaluar pa u vënë re si ndërmjet një publiku të edukuar me artin ashtu dhe me atë që arti është hobi dhe kënaqësi shijimi. Natyrisht që krijimtaria e saj veçohet për një ndjesi që kalon përmes cilësive të saj intelektuale. Këto cilësi në mënyrë të qartë dhe intesive ajo i rrit duke i qëndruar pranë fjalës, të cilën përpiqet ta përdorë, por dhe ta shijojë si një bizhu moderne dhe aktive rreth veprës së artit pamor. Ajo arrin të kombinojë fjalën, e cila përzgjidhet si element i komunikimit të shpejtë, me figurën si element i memorizimit të shpejtë. Kjo i rrit interaktivitetin dhe atraktivitetin veprës së saj dhe e bën të qartë jo vetëm ndaj publikut, por arrin të dalë gjithësisht jashtë, prej Venerës si njeri dhe si artiste. Pjesëmarrja e saj më e fundit në Bienalen e Venecias është qëndrimi artistik individual përballë një publiku elitar e përzgjedhës, por edhe të përditshëm, që gjykojnë dhe vlerësojnë pjesëmarrjet në varësi të zhvillimit të artit pamor për vitin 2009. Nga pjesëmarrja e artistëve shqiptar në këtë edicion vihet re se pjesëmarrja ka ardhur si rezultat i mbështetjes dhe nxitjes private, dhe kjo nxjerr në pah mosaktivizimin dhe mosorganizimin shtetëror shqiptar në këtë ngjarje të rëndësishme të artit në botë. Nuk është më koha që artistët shqiptar, që jetojnë në Shqipëri apo jashtë saj, të mos arrijnë të ekspozohen nën financimin e shtetit, strukturat e të cilit janë të gjitha të ngritura në MTKRS, madje dhe disa herë kanë bashkëpunuar që këto pjesëmarrje të realizohen në Bienalen e Venecias. Le të mendojmë se vazhdimësia nuk është vetëm domosdoshmëri, por dhe identitet dhe dinjitet artistik i shqiptarëve për në BE.

Ju jetoni jashtë Shqipërisë prej disa kohësh. Cilat kanë qenë arsyet e largimit prej saj?

Kërkimi për të ekzistuar, ekzigenca për të shprehur vetveten në të gjitha format e mundësitë. Për të përjetuar realisht ëndrrën time të përhershme për një bordërlinë të lirë ku ideja zhvillohet e merr formë. Që fëmijë shihja përpara jetën time të sotme në formën e një përgjumje trilluese. Imagjinoja fëmijët jashtë kufiri si persona që gëzonin të gjitha të drejtat njerëzore dhe realisht ekzistonin në qenien e tyre tërësore. Zërat që flisnin në gjuhë të ndryshme të këtyre fëmijëve të largët më jepnin një arsye më shumë për të jetuar e kërkuar linjën e mistershme.

Cili është edukimi juaj dhe përse vendosët të merreni më artin pamor?

Që kur isha akoma në hapat e para të viteve shkollorë, për shkak të pasionit të babait tim iu afrova me ndrojtje artit, pikërisht muzikës, nëpërmjet instrumentit që akoma sot e adhuroj violinës. Pas 5 vjet studimi me zgjedhjen time të plotë e të vetëdijshme fillova të eksploroja rrugën e artit viziv, sigurisht duke filluar me pikturën klasike e njohjen e formës reale. Duke u ndjerë gjithmonë e më e joshur nga kjo shprehje artistike, përfundova në fillim Liceun Artistik “Jordan Misja” e më pas Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë ku pata eksperiencën të bukura dhe interesante. Më vonë pata fatin dhe mundësinë për të eksperimentuar forma më të reja multimediale nëpërmjet viteve të studimeve të mia më të fundit në Akademinë e Arteve të Brerës në Milano. Ishte kjo e fundit që më dha siguri akoma më të mëdha në vetvete e më hapi një këndvështrim të ri, siç është ai i videoartit dhe ki-

Pjesëmarrja e saj më e fundit në Bienalen e Venecias është qëndrimi artistik individual përballë një publiku elitar e përzgjedhës, por edhe të përditshëm, që gjykojnë dhe vlerësojnë pjesëmarrjet në varësi të zhvillimit të artit pamor për vitin 2009. Por siç thotë vetë Venera, artisti shqiptar që jeton jashtë kufijve të Shqipërisë, duke punuar në mënyrë individuale mund të prezantohet me dinjitet në nivelin ndërkombëtar duke hasur vështirësi të mëdha e të njëpasnjëshme, e mbi të gjitha pa mbështetje kombëtare.



Venera Kastrati

Në Bienalen e Venecias pavijoni shqiptar ende në dhomën e pritjes

nemasë. Tema e mbrojtjes së diplomës “Takim me Hitchcock e Truffaut. Kinemaja dhe Psikoanaliza”, e cila u vlerësua nga juria me rezultatin më të lartë, ishte drejtpërdrejt e lidhur me kinemanë e heshtur dhe psikoanalizën, gjithmonë e më shumë në trajtim edhe në punët e mia të fundit. E zhytur tashmë në artin pamor, në distancë e kohë, mendoj që një nga faktorët kryesorë që më bën të jem pjesë e këtij pasioni është mundësia e pashpërblyeshme që më ofron arti për të komunikuar.

Çfarë vendi zë letërsia në jetën tuaj? Tashmë një publik i mirëinformuar e njeh gjuhën tuaj, por një publik i gjërë e dëshiron rrëfimin tuaj rreth stilit të letërsisë që ju aplikoni. Cili është ai?

Kjo pyetje ka në mes një element të rëndësishëm për sa i përket krijimtarisë sime e më intereson shumë. Tregimi në formë poetike, por jo në formë rrëfimi, ka gjithmonë e më shumë një vlerë të veçantë në zhvillimin e ideve të mia në paraqitjen përfundimtare të veprës. Paraqitja e një forme artistike jo direkte për publikun, që nuk godet si rezultat i kërkesës së publikut por stimulon reflektimin, dhe që është në gjendje të flasë në shumë gjuhë, është baza e krijimtarisë sime. Në fillimet e afimit tim me letërsinë, kur banoja akoma në Tiranë, një nga autorët që më mahniti me gjuhën e tij të mrekulluehme poetike ishte Balzaku. Tashmë ndjej gjithmonë e më shumë interes si për letërsinë historike dhe poetike, edhe për letërsinë psikoanalitike, që kanë të bëjnë edhe me analizën e psikologjinë e fazave të para të zhvillimit të identitetit të njeriut, dmth të fëmijërisë. Ndër to mund të përmend

Winnicott (një libër i tij që më ka ngelur në mendje “Loja dhe realiteti”), apo Kafka më të famshmin libër “Metamorfoza”, apo një nga autorët letrar që më ka lënë të befashuar e të mahnitur është Agota Kristof me “Trilogjia e qytetit K”. Një nga arsyet që jam e tërhequr nga kinemaja është pikërisht tipologjia e zhvillimit të ngjarjes llogjike apo jo, dhe gjithë elementet artistikë të përmbledhura në një vepër komplekse të vetme të një artisti siç është regjisti; fotografia, muzika, poezia, ritmika, e shumë të tjera.

A e dini se kur themi art pamor çdo mendim i zakonshëm lidhet me pikturën? Si mendoni përse?

Piktura gjen origjinën e vet më të lashtë në rrëfimet vizive dhe mundësitë ofruese të elementeve dekorative për të komunikuar. Publiku i pa informuar për artin bashkëkohor akoma sot, e bën referim e pikturës si element të vetëm komunikues e nënkuptues të artit pamor. Kjo ndodh nga mungesa e informacionit historik duke filluar që me fëmijët e shkollave fillore, dhe pamundësia e edukimit të tyre viziv nëpërmjet muzeve dhe të gjitha dokumenteve më aktuale, kulturore e artistike. Kjo mungëse ndihet edhe në nivelin publik italian, pikërisht si rrjedhim i edukimit jo të rinovuar në shkollat fillore e të mesme ose nga mungesa e informacionit didaktik që nga mësuesit vetë. Piktura e humbi vlerën e saj të dokumentimit me lindjen e fotografisë. Nevoja për të identifikuar forma të reja artistike bidimensionale vazhdoi akoma deri me fillimin e luftës së parë botërore, deri sa revolucionet historike patën një influencë edhe në shndërrimet rrën-

jësore artistike. Kështu më surrealistët (Duchamp e Breton), me shkollën e Bauhausit e duke arritur deri tek pop art, land art e konceptualizmi, art pamor u largua gjithmonë e më shumë nga origjina e vet e memories kolektive, që ishte piktura. Këto informacione janë të arritshme për një publik të vëmendshëm apo të interesuar direkt mbi artin bashkëkohor.

Si rezultat i edicionit të fundit të Bienales së Venecias, një vëmendje rikthyese i është dedikuar pikturës. Duket më shumë një rikërkim drejt së bukurës dhe elegancës vizive, i ndjeshmërisë poetike që nganjëherë humb vlerat e saj me kohën o më mirë me modat e ndjekura nga individit-artist, që në të shumtën e rasteve shfaqen e humbin gjurmë, pikërisht pasi flasin vetëm gjuhën e tyre e qëndrojnë të izoluar me kohën kur lindin e vdesin. Kështu mendimi im për artin pamor sot, është një element pa kufij të përcaktuar, të gjitha gjuhët artistike mund të gërshetohen apo të izoloohen, me kusht që të jenë në gjendje të komunikojnë e të lenë një mesazh për publikun, i cili ndihet pjesë aktive e veprës. Ai është një art që kërkon një publik që reagon me informacionin e lëshuar nga artisti e jo që qëndron pasiv përballë saj. Ai e kthehen në një kontenitor.

Çfarë vendi zë piktura në ditët e sotme në Shqipëri dhe më gjërë?

Jam e mendimit që në Shqipëri duhen dhënë akoma vlerat e duhura, duhen bërë kërkime mbi artin e zhvilluar përgjatë viteve të izolimit diktatorial e më pas në vitet që vijojnë, duke i dhënë kështu një arsye zhvillimit artistik me kohën që jetoj e jeton sot. Memoria historike ka një rëndësi të veçantë për sa i përket identitetit të një kombi e si rrjedhim edhe atij individual.

Krijimtaria është çështja e parë e ditës për ju apo mbijetesa?

Të dyja bashkë. Krijimtaria është nevojë primare mendore. Mbijetesa është nevojë primare fizike. Për mirëqenien e një personi është i nevojshëm ekuilibri midis të dyjave.

Cili qe momenti i parë i angazhimit tuaj në ekspozimet në vendin ku jetoni dhe në konkurset ndërkombëtarë?

Ideja ime fillestare kur nisa studimet në akademinë e Milanos ishte të informohesha sa më shumë me çdo të re që ofronte institucionin më prestigjioz i formimit artistik në Itali siç ishte Brera dhe afrimi im me institucionet publike e private ekspozues për të ballafaquar një publik të ri, të huaj. Disa nga veprimtaritë e mia kryesore akoma në vitet e para akademike milaneze ishin ekspozita personale në “Spazio Umano”, “Sudio Casoli” në Milano. Vijuan ekspozita të tjera në bashkëpunim me kuratoren Francesca Pasini. Më pas në Sofie në “XXL”, me galerinë “Pianissimo”, në palazzo Farnese, në Ortona me kuratorin Edi Muka e deri në pjesëmarrjen time në eventin e Kole-